



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-28278/24 datë:23.10.2024



Npi – 01/352 datë: 29.10.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 29.10.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -X- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 29.10.2024 (e martë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtori i DPUKGGJ-së z.Grejtalb Emini, Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Drejtoresha e DSHMS-së znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, Asistentrja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.09.2024,
2. Raporti nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024,
3. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (diskutim publik)
4. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përbalueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024,
6. Propozim-Vendim për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes të përgjithshëm,
7. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)
8. Propozim-Vendim për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.09.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 25.09.2024.**

Pika 2

Raporti nëntëmuor buxhetor Janar-Shtator 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Raportin nëntëmuor buxhetor Janar-Shtator 2024, e kemi obligim ligjor nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, për ta prezantuar në Kuvend dhe në KPF, për të pare ecurinë dhe nivelin e realizimit të buxhetit. Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, kështu që unë nuk do ta zgjati me detaje por do ti lexoj pikat kryesore të dhëna sipas kodeve ekonomike dhe pastaj nëse ka ndonje pyetje do te pergjigjem (shih dokumentin). Me rendësi është me përmend faktin se buxheti deri tani është realizuar 70.11%, ose 7.7 milion euro dhe unë besoj se deri në fund të vitit do ti afrohem shumë realizimit me njëqin për qind.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota + (me votën e dyfishtë të Kryesuesit) me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 votë “Abstënim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit nëntëmuor buxhetor Janar-Shtator 2024.**

Pika 3

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025, (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Tek jo pike, ne e kemi obligim ligjor për me prurë në Kuvend për miratim. Tash për tash nuk kemi ndonjë propozim të ri për ndryshim të kësaj draft-rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025. Por meqenëse ky draft duhet me shku në diskutim publik, është e mundur që të kemi ndonjë propozim për ndryshim. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje. Gjithnjë po na vjen me shifra të njehta, ku nuk mundemi me ba ndryshime, prandaj unë mendoj se nuk ka nevojë me ardhë në Kuvend. Pytja ime është për drejtorin, a ka mundësi që kjo draft-rregullore mos me na ardhur në Kuvend?

z.Përparim Ramusa: Unë ju përgëzoj që këtë vit e keni prurë me kohë, draft-rregulloren për taksa për vitin 2025 në Kuvend. Është obligim ligjor për me prurë në Kuvend, dhe unë jam “për” miratimin e vendimit për ta dërguar në diskutim publik.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me zyrën për informim.**

Pika 4

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, siç e dini ne e kemi listen e pronave komunale që mund ti japim në shfrytëzim afatgjatë, që është edhe obligim ligjor. Tani ne si drejtori po i propozojmë Kuvendit për me zgjedhë Komisionin i cili do ti shqyrton kërkesat për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Është me rendësi që ky Komision me kalu dhe me u hapë rruga për bizneset. Propozim-vendimin e keni marrë dhe e keni lexuar (shih dokumentin) dhe ju ftoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit, është mire me marrë këtë iniciativë, mirëpo siç e dini ne kemi vendosë që kërkesat fillimisht me shku në drejtori, Kryesues, a kemi ne punë me këto kërkesa?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kërkesat shkojnë fillimisht në drejtori ashtu qysh është e rregulluar me rregulloren e punës së Kuvendit, dhe pastaj Komisioni bashkë me rekomandimin e drejtorisë i shqyrton kërkesat e palëve dhe i rekomandon Kuvendit, e Kuvendi e merr vendimin përfundimtar.

z.Përparim Ramusa: Unë mendoj se Komisioni është pak i vonuar, kështu është dashur me e bërë ju qysh në fillim. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të trajtohen drejt kërkesat. Ne jemi “për” formimin e këtij Komisioni, ndërsa emrin e kandidatit nga opozita e japim në mbledhjen e Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për formimin e Komisionit për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim.**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Nga MAPL-ja e kemi pranuar një rekomandim me numër Nr.020-618-5 dt.17.10.2024 për shqyrtimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm dhe social, të cilin Kuvendi e ka miratuar në mbledhjen e kaluar më 27.09.2024. Ajo qka ka ndodhur është se zyrtarët tanë kur e kanë bërë propozim-vendimin nuk e kanë marrë parasysh nenin 25 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, e për të cilin MAPL-ja e ka kthyer mbropa për ta plotësuar vendimin edhe me këtë nen të baza ligjore. Meqenëse gabime pa qëllim mund të bëjmë të gjithë, ju ftoj që ta votoni këtë ndryshim.

z.Përparim Ramusa: E kuptojmë rekomandimin e MAPL-së, kështu që ne do ta përkrahim këtë ndryshim në këtë vendim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024.**

Pika 6

Propozim-Vendim për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes të përgjithshëm

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje. Materialin për këtë propozim e keni marrë. Bazën Ligjore e keni pa. Pronat që do të shpronësohen për hapjen e rrugës së re që i lidh rrugën "Villiam Voker" me rrugën "12 Qershori" i keni të gjitha në propozim-vendim. Ne po tentojmë me i lidhë këto rrugë edhe me rrugët "Imer Devetaku" dhe rrugën "Mic Sokoli". Aty do të rrënohet shtëpia e Fadil Nuha dhe do të zgjerohet rruga deri te rrethrotullimi që do të ndërtohet dhe ku do të lidhen me rrugën "Komandant Kumanova". Kjo tani për tani mund të ju duket pak e rendësishme por pas disa viteve do të shihen efektet e këtyre projekteve. Kjo rrugë do të bëhet me gjithë infrastrukturën përcjellëse. Kërkoj që me pa arsyesherinë dhe ju ftoj që ta votoni. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu që të përgjigjem.

z.Lumni Amrushi: E kuptoj shqetësimin e drejtorit për KEDS-in. Unë mendoj se është mire që po bëhet kjo rrugë sepse është në interes për banorët.

z.Përparim Ramusa: Me këtë propozim a po bëhet fjalë për një rrugë të re që do ti lidhë rrugët "Villiam Voker" me rrugën "12 Qershori" nëse është fjala për këtë rrugë ne jemi "për".

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Ky shpronësim ka të bëjë ekskluzivisht me lidhjen e rrugëve "Villiam Voker" me rrugën "12 Qershori", ku më së shumti do të preken familjet Ramadani. Rruga do të jetë me 9 metra gjerësi.

z.Lumni Amrushi: Te pjesa e rrugës "Mic Sokoli" nuk kemi informata çka po bëhet, sepse siç dihet për atë pjesë e kemi miratuar një vendim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Sa i përket rrugës "Mic Sokoli" jemi duke punuar me Ministrinë, dhe në mbledhjen e muajit Nëntor do ta dime shumë më saktë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes të përgjithshëm.**

Pika 7

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Kjo draft-strategji dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2025-28 ka me dalë në diskutim publik, dhe aty do ta ketë secili rastin që ta jep kontributin e vetë. Për vitin e ardhshëm kostoja e këtij projekti është planifikuar të kushtojë rreth 35 mijë euro. Draft-strategjinë e keni pranuar me kohë dhe besoj e keni

lexuar, nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem dhe në fund ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit që ta nxjerrë në diskutim publik.

znj. Adelina Beqaj: E kamë vërejtë që te shkolla është ndaluar për prindërit me i qu fëmijët e tyre deri brenda në shkollë, unë nuk e shoh të arsyeshme sepse ka fëmijë me epilepsi ose që janë me shëndet të dobët, kështu që le të gjindet një alternativë, dhe të diskutohet në këtë strategji, sepse nuk bënë që fëmijët me 12 kg. çantë në shpinë me u ngjitë shkallëve të shkollës.

znj. Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: E kuptoj shqetësimin e juaj, dhe le të diskutohet kjo çështje gjatë procesit të diskutimit publik.

z. Përparim Ramusa: E përgëzoj drejtoreshën që tani ne po e diskutojmë edhe këtë çështje për sa u përket personave me aftësi të kufizuara, sepse më heret për arsye të ndryshme nuk kemi pas mundësi. Ne do të kontribuojmë gjatë diskutimit publik, dhe i ftoj të gjithë që të jenë aktiv. Ne jemi “për” që kjo draft-strategji të del në diskutim publik.

z. Lumni Amrushi: Është mire që me i marrë edhe rekomandimet nga Shoqatat që merren drejtpërdrejt me personat me aftësi të kufizuara, me arsyetimin që Vendimin që do ta marrim në Kuvend të jetë sa më i mire dhe më i qëndrueshëm.

z. Përparim Ramusa: Po flas në emër të grupit parlamentar të PDK-së, ne jemi “për” për fardo që do të ketë nevojë për këtë kategori ne do ta përkrahim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2025-28. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me zyrën për informim.**

Pika 8

Propozim-Vendim për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Përparim Ramusa: Ne jemi “për” por më e mira do të ishte për me qenë drejtori këtu present dhe me na prezantuar këtë pikë dhe me na dhënë shërbime.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Drejtori me siguri që do të na jep shërbime në mbledhjen e Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes.**

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:19h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

